



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Nr. 335-01/25
Data:31.10.2025
B U J A N O C

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr. 311-01 /25, datë 27.10.2025, shpallim:

THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJEN E PROJEKT-PROPOZIMEVE NË FUSHËN E ARTIT, KULTURËS DHE TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE NË LUGINË TË PRESHEVËS DHE SANXHAK

QËLLIMI I THIRRJES

Qëllimi i kësaj thirrjeje është mbështetja e projekteve që nxisin dhe promovojnë artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore shqiptare në Luginën e Preshevës dhe Sanxhak, si pjesë thelbësore e ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit kombëtar në Luginë të Preshevës dhe Sanxhakut, që Këshilli Kombëtar Shqiptar zbaton në bazë të ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e **Republikës së Kosovës për vitin 2025, nga organizata buxhetore “Zyra e Kryeministrit”, nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës dhe Sanxhakun" me kod 3910**. Kjo thirrje synon të fuqizojë organizatat kulturore, grupet artistike, krijuesit individual artistik e kulturor, shoqëritë kulturor-artistike e të ngjashme, të cilët kontribuojnë në ndërtimin e një jete të gjallë kulturore, si një shtyllë e identitetit kombëtar dhe që pasqyron vlerat tradicionale dhe moderne të kulturës shqiptare në Luginë të Preshevës dhe Sanxhak.

Qëllimi kryesor i mbështetjes është:

Të kultivohet dhe promovohet identiteti kombëtar shqiptar përmes ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale shqiptare në Luginën e Preshevës dhe Sanxhak;

Të nxitet shprehja artistike dhe krijimtaria tek të rinjtë dhe komuniteti;

Të kontribuohet në krijimin e hapësirave publike kulturore dhe aktiviteteve të hapura;

Të fuqizohet qasja në kulturë dhe arsimim artistik për fëmijë dhe të rinj;

Të stimulohet bashkëpunimi ndër gjeneratash në kultivimin e identitetit kombëtar shqiptar;

Të krijohen lidhje dhe bashkëpunime me artistë dhe organizata nga Kosova, Shqipëria dhe diaspora.

Mbështetja do t'u jepet projekteve që kontribuojnë në:

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

- Organizimin e aktiviteteve kulturore si: festivale, ekspozita, performanca, koncerte, recitale, kinema alternative etj.;
- Dokumentimin e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve në Luginë dhe Sanxhak.
- Botime dhe publikime me karakter kulturor e historik;
- Krijimin dhe promovimin e veprave të reja artistike (arti pamor, muzikë, film, letërsi, teatër etj.);
- Aktivitetet e edukimit joformal dhe punëtoritë edukative artistike;
- Promovimin e artizanatit dhe zejeve tradicionale shqiptare;

Përparësi do të kenë projektet që:

Janë të qarta, të realizueshme dhe me ndikim të qëndrueshëm;

Ofrojnë qasje të barabartë, fuqizojnë rolin e të rinjve dhe të grave shqiptare në sektorin kulturor.

Fokusohet në trashëgiminë kulturore shqiptare të rrezikuar ose të marginalizuar;

BUXHETI DHE SHUMAT E DISPONUESHME

Buxheti total i planifikuar për këtë thirrje, në kuadër të mjeteve të dedikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2025 për Luginën e Preshevës dhe Sanxhak, është 250,000 euro.

Shuma minimale për një projekt është 1,000 euro, ndërsa shuma maksimale që mund të kërkohet është 20,000 euro.

Mbështetja financiare do të ndahet në mënyrë të drejtë dhe të balancuar, bazuar në përvojën, përmbajtjen dhe ndikimin në komunitet të projekteve, sipas këtyre kufizimeve të përcaktuara:

Organizatat e reja, të regjistruara :0-2 vite para hapjes së Thirrjes, kanë të drejtë të aplikojnë për projekte në shumën deri në 5,000 euro

Grupet joformale kanë të drejtë të aplikojnë për projekte në shumën deri në 3,000 euro

Organizatat të themeluara 2-5 vite para hapjes së Thirrjes, me përvojë në zbatim projektsh kulturore: kanë të drejtë të aplikojnë për projekte në shumën deri në 10,000 euro

Organizatat të regjistruara mbi 5 vite para hapjes së Thirrjes, me përvojë në zbatim projektsh kulturore që parasheh kjo thirrje: kanë të drejtë të aplikojnë për projekte në shumën deri në 20,000 euro

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Krijuesit individual artistik e kulturor kanë të drejtë të aplikojnë për projekte në shumën deri në 1.000 euro

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm për të qenë të pranueshëm:

Formulari i plotësuar i aplikimit

Projekt-propozimi i detajuar (përshkrim, objektiva, aktivitetet, kohëzgjatje)

Buxheti i detajuar i projektit

Certifikata e regjistrimit të organizatës (Origjinali ose kopje e noterizuar);

Statuti i organizatës (Origjinali ose kopje e noterizuar);

CV e drejtuesit dhe e të gjithë anëtarëve të ekipit të paraparë në projekt;

Raport mbi aktivitetet e realizuara (nëse ka);

Deklaratë për përputhshmëri me kriteret e thirrjes;

Dëshmi për projekte të mëparshme të realizuara (nëse ka) ;

Letër mbështetjeje nga partnerë lokalë (nëse aplikohet në emër të një bashkëpunimi);

Deklaratë se të dhënat janë të sakta.

VËREJTJE:

1: Organizatat apo individët të cilët kanë qenë përfitues të granteve në vitin 2022, e të cilët nuk kanë dorëzuar pranë KKS Raporte të rregullta sipas kontratës, sikurse organizatat që kanë përfituar nga Buxheti i Republikës së Kosovës përmes Ministrive gjatë këtij viti (2025), do të eliminohen nga Konkursi!

2: Organizatat e themeluara pas shpalljes së konkursit (thirrjes) nuk do të shqyrtohen;

3. Organizata mund të jetë përfituese vetëm në njërën thirrje;

4. Kufizimi i lidhjes familjare: vetëm 1 aplikues (përfaqësues ligjor) nga lidhja ngushtë familjare(bashkëshort-bashkëshorte, prind-fëmij dhe aplikues-prind) mes aplikuesve do të pranohet për në fazën e vlerësimit të aplikimit (në rast se paraqiten raste të tilla, përparësi do të ketë aplikuesi i cili ka aplikuar i pari).

Poashtu nuk do të projekt propozimet e aplikuesit (përfaqësuesit ligjor) i cili ka lidhje të ngushtë familjare me anëtarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar (bashkëshort/e, fëmijët dhe prindërit e anëtarit të KKS) meqë llogariten si konflikt interesi.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

5. Të drejtë aplikimi kanë organizatat të cilat kanë selitë e tyre në Preshevë, Bujanoc, Medvegjë dhe Sanxhak dhe me themelues shqiptar (të kenë shumicën e themeluesve ose anëtarëve të organizatës, shqiptar dhe të jenë të deklaruar si shqiptar në listën e veçant zgjedhore për këshillat kombëtar)

PROCESI I ZBATIMIT TË THIRRJE

- a. **Shpallja e thirrjes publike:** Thirrja publikohet në faqet zyrtare të KKSh dhe rrjetet sociale dhe mediat lokale. Aplikimi do të jetë i hapur për 15 ditë nga dita e publikimit.
- b. **Pranimi i aplikimeve:** Aplikimet duhet të dorëzohen fizikisht në selinë e Këshillit Kombëtar Shqiptar apo në njërën nga zyrat në Preshevë, Medvegjë apo Novi Pazar **më së voni ora 15:00, datë 14.11.2025..** Secilit aplikim do t'i jepet një numër protokolli.
- c. **Verifikimi administrativ:** Staf i administrativ do të verifikojë plotësinë e dokumentacionit. Aplikimet me dokumentacionin e dorëzuar të paplotë, do të refuzohen.
- d. **Vlerësimi profesional:** Komisioni i përberë nga 3 profesionist të pavarur në fushën e kulturës dhe menaxhimit të projekteve do të vlerësojë çdo projekt sipas kriterëve të përcaktuara.
- e. **Përzgjedhja dhe publikimi i përfituesve:** Lista përfundimtare e përfituesve do të publikohet në mënyrë transparente dhe do të njoftohen edhe në mënyrë individuale.
- f. **Nënshkrimi i marrëveshjeve:** Me përfituesit do të nënshkruhen kontrata që përcakton detyrimet, afatet dhe mënyrën e zbatimit të projektit.
- g. **Zbatimi dhe monitorimi i projekteve:** Përfituesit do të kenë detyrimin të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare periodik. Aktivitetet do të monitorohen nga një ekip i dedikuar nga KKSh për të siguruar transparencë dhe efektshmëri.

e. Raporti final.

Secili përfitues i projektit obligohet të dorëzojë raportin final narrativ dhe financiar me dëshmi të realizimit të projektit.

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në www.kksh.org (website i KKSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në kksh.grantet@gmail.com ose na telefononi në nr. 00 381 17 853 264.

Vërejtje: Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës

